<p>Takimi i pesëmbëdhjetë i komisioneve SHKODËR 27 SHKURT 2015</p>	<p>Republika e Kosovës</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. M. Meha</li> <li>2. S. Ukshini</li> <li>3. T. Basha</li> <li>4. D. Krasniqi</li> <li>5. R. Murati</li> <li>6. E. Xani</li> </ol>	<p>lidhur me pikën e përbashkët të kufijve shtetëror të Republikës Kosovës, Malit të Zi dhe së Republikës Shqipërisë, e cila është e shënjuar me shenjën e kufirit tresh dhe mirëmbajtjen e saj, nga takimi i mbajtur në Podgoricë, datë: 25.07.2014. Njëkohësisht, komisioni malazet njoftoj se Qeveria e Malit të Zi, me 16. tetor 2014. ka aprovuar Raportin mbi aktivitetet në përgatitjen e propozim marrëveshjes si dhe ka aprovuar propozimin, gjë me të cilën ka konfirmuar se janë përbushur procedurat e brendshme ligjore, të duhura për nënshkrimin e marrëveshjes në fjalë.</p> <p>4. Janë bërë ndryshime në Nenin 2 të Marrëveshjes së parafuar të kufirit shtetëror ndërmjet Republikës Kosovës dhe Malit të Zi, në pikën e takimit të kufirit tresh, Republikës së Kosovës, Malit të Zi dhe Republikës së Shqipërisë.</p> <p>5. Po ashtu, është harmonizuar Neni 3 i Marrëveshjes mbi pikën e kufirit tresh me palën kosovare, ashtu që nga versioni malazet i Marrëveshjes, i cili është aprovuar në seancën e Qeverisë së Malit të Zi, me 16. tetor 2014, në mënyre identike janë bartë të dhënat nga tabelat (lartësia mbidetare e piramidës në kufirin tresh, është shtuar mënyra e matjes “elipsoide”, gjegjësisht “ortometrike”, për shkak të diferencës në lartësi).</p> <p>6. Grupet e përbashkëta të ekspertëve për dokumentacion dhe identifikim të linjës kufitare mes dy shteteve kanë vazhduar punën në harmonizimin e vijës së aprovuar kufitare në hartat kadastrale ekzistuese dhe në hartat topografike, të cilat gjenden të bashkangjitura në shtojcën 1 të këtij Procesverbali. Në këtë takim u arrit të përcaktohen koordinatat e pikave thyese nga kufiri tresh i Republikës Kosovës, Malit të Zi dhe Republikës së Shqipërisë në drejtim të kufirit tresh Republikës dhe Republikë e Serbisë. Pikat kufitare, koordinatat e pikave thyese dhe linja kufitare e skicuar në Hartën topografike 1:25000, janë shtojcë e Marrëveshjes mbi kufirin shtetëror të Republikës Kosovës dhe Malit të Zi dhe janë pjesë përbërëse e saj. Procesverbali është përpiluar në dy ekzemplare origjinale në gjuhën shqipe dhe atë malazeze, dhe te dy tekstet janë identike. Takimi i radhës është paraparë të mbahet në Shkodër, rreth datave 8-10. dhjetor 2014. Bisedimet u zhvilluan në frymë të mirëbesimit dhe të respektit të ndërsjellë.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. U harmonizua dhe u nënshkrua Procesverbali nga takimi i katërbëdhjetë i komisioneve kufitare të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, i mbajtur në Prizren, me datë: 21.11.2014, ku janë konfirmuar 208 pika thyese gjatë linjës kufitare.</li> <li>2. U harmonizua linja kufitare, nga kufiri tresh Republikë e Kosovës, Mali i Zi dhe Republikë e Shqipërisë, deri te kufiri tresh, Republikë e Kosovës, Mali i Zi dhe Republikë e Serbisë.</li> <li>3. Komisionet shprehën gatishmërinë të përgatisin përshkrimin dhe numërimin të pikave kryesore thyese të linjës kufitare për pjesën e harmonizuar të saj.</li> </ol>
--	---	--

<p><b>Takimi i gjashtëmbëdhjetë: PRISHTINË 08,09 QERSHOR 2015</b></p>	<p>Mali i Zi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. M.Paunović</li> <li>2. A.Vukčević</li> <li>3. R. Sekulović</li> <li>4. V.Femić</li> <li>5. E.Ljučaj,</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>4. Komisionet janë dakorduar që të përgatisin tekstin final të Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze, me korrigjimet tekniko-ligjore, si dhe hartat topografike 1:25000 , me linjën e harmonizuar dhe të skicuar, me qëllim të harmonizimit dhe parafimit (pjesë përbërëse e Marrëveshjes).</li> <li>5. Komisionet do t'i përfundojnë procedurat e brendshme ligjore, të duhura për nënshkrimin e Marrëveshjes në fjalë, pas të cilave do të nënshkruhet Marrëveshja</li> <li>6. Takimi i gjashtëmbëdhjetë i komisioneve kufitare të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, do mbahet në Prishtinë, ku do të harmonizohen dhe parafohen të gjitha dokumentet kufitare.</li> </ol>
	<p>Republika e Kosovës:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. M. Meha</li> <li>2. Sh. Guda</li> <li>3. B. Kajtazi</li> <li>4. S. Ukshini</li> <li>5. T. Basha</li> <li>6. D. Krasniqi</li> <li>7. E. Xani</li> <li>8. R. Murati</li> </ol>	<p>U harmonizua dhe u nënshkrua Procesverbali nga takimi i pesëmbëdhjetë i komisioneve kufitare të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, i mbajtur në Shkodër, datë 27 shkurt 2015;</p> <p>2. Në takimin e mbajtur në Podgoricë nga data 27 deri më 29 maj 2015, Komisioni Kosovar ia ka dorëzuar palës malazeze hartën e Institutit për Pylltari dhe Industrinë e Drurit të vitit 1979 në shkallë 1:10000 të marrura nga Agjencia Kosovare e Pyjeve me të cilën kishte bërë menaxhimin e pyjeve i është dorëzuar Komisionit malazez në takimin e kaluar për sjelljen e dokumentacionit të tyre. Përgjigja e Komisionit malazez për këtë sipërfaqe ishte sjellja e dokumentacionit relevant (hartave dhe fletëve poseduese) në takimin e Prishtinës të datës 08.06.2015 të cilat janë: Fletët poseduese të sipërfaqes që përfshihet nga blloqet e pyjeve 34-44 dhe 56-62. Këto prona janë të regjistruara në zonën kadastrale Balotic, të komunës së Rozhajës, në fletët poseduese me numër 142 dhe 394, si dhe hartën e kadastrit përshkrues blloku 24. Në bazë të këtyre dokumenteve, vërtetohet se këto prona janë në pronësi shtetërore të Malit Zi.</p>
	<p>Mali i Zi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.M.Paunovic,</li> <li>2. S. Čabarkapa,</li> <li>3. R. Sekulovic,</li> <li>4. V. Femic,</li> <li>5. D. Gjonbalaj,</li> <li>6. E. Lucaj,</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>3. Gjatë këtij takimi u analizua dhe u shqyrtua edhe njëherë atlasia pedologjik i punuar nga Instituti i Beogradit më 1974, dhe për këtë Komisioni malazez solli dëshmi valide kadastrale, fletë poseduese dhe hartën grafike, që ajo pronë është në pronësi të Malit të Zi.</li> <li>4. Duke diskutuar detajisht pjesën e linjës kufitare e cila ka mbetur e pa harmonizuar gjatë takimeve të mbajtura në Shkodër më 27.02.2015 dhe në Podgoricë me datat: 27, 28 dhe 29 maj 2015, lidhur me pjesën e quajtur "Stanet e Loxhes", pala malazeze ka sjellur dokumentacionin kadastral të komunës së Rozhajës - zona kadastrale Dacic, ku vërtetohet se pjesa e diskutuar është në kuadër të fletës poseduese 62, parcela 14/1, sipërfaqe 20 hektar, kullosë e klasës së 5 (pestë), pronë shtetërore e Malit të Zi.</li> <li>5. U arrit marrëveshja që të përpilohet një hartë topografike në të cilën do të paraqitet linja ndërmjet dy shteteve dhe në bashkëngjitje të jetë edhe regjistri i koordinatave për pikat thyese si pjesë</li> </ol>

		<p>përbërëse e materialit tekstual për vijën kufitare ndërmjet Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës. Gjithashtu është arritur pajtueshmëri për numërimin e pikave thyese në vijën kufitare.</p> <p>6.Pala malazeze dhe ajo kosovar harmonizuan dhe e parafuan tekstin final të Marrëveshjes mbi kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.</p> <p>7.U harmonizuan dhe u parafuan hartat topografike në shkallë 1:25000, me linjën kufitare dhe koordinatat e pikave thyese kufitare (Shtojca 1 e Marrëveshjes).</p> <p>8.U harmonizua dhe u parafua Përshkrimi tekstual i shtrirjes së kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi (Shtojca 2 e Marrëveshjes).</p> <p>9.Ka përfunduar demarkacioni dhe përcaktimi i kufirit shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi . Marrëveshja mbi kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi do të nënshkruhet pas zbatimit të procedurave ligjore në Republikën e Kosovës dhe Malit të Zi.</p> <p>10. Në pajtim me Udhëzuesin e përbashkët për shënjimin e kufirit shtetëror, mirëmbajtjes së linjës kufitare, shenjave kufitare dhe brezit kufitar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, do të bëhet shënjimi i vijës kufitare shtetërore, të përcaktuar sipas Marrëveshjes, në afat prej dy viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.</p> <p>Takimi u zhvillua në frymë të mirëbesimit dhe respektit të ndërsjellë.</p> <p>Procesverbali u përpilua në tre ekzemplar origjinal, në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze, ku i tërë teksti është njëloj - autentik.</p>
--	--	---



**Republika e Kosovës**  
*Qeveria e Republikës së Kosovës*

*Komisioni shtetëror për shënjimin dhe  
mirëmbajtjen e kufirit shtetëror*



**Mali i Zi**  
*Qeveria e Malit të Zi*  
*Ministria e punëve të brendshme*

*Komisioni për demarkacion  
dhe përcaktimin e kufirit shtetëror,  
caktimin e kalimeve kufitare, përcaktimin  
e regjimit të trafikut nderkufitar me  
shtetet fqinje dhe zbatimi i strategjisë së  
menaxhimit të integruar të kufirit*

## **RREGULLORE PËR PUNËN E PËRBASHKËT**

të

**Komisionit shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror të  
Republikës së Kosovës**

dhe

**Komisionit për demarkacion  
dhe përcaktimin e kufirit shtetëror,  
caktimin e kalimeve kufitare, përcaktimin e regjimit të trafikut nderkufitar me  
shtetet fqinje dhe zbatimi i strategjisë së  
menaxhimit të integruar të kufirit të Malit të Zi**

### **Neni 1**

Me këtë Rregullore, Komisioni shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës, dhe Komisioni për demarkacion dhe përcaktimin e kufirit shtetëror, caktimin e kalimeve kufitare, përcaktimin e regjimit të trafikut nderkufitar me shtetet fqinje dhe zbatimi i strategjisë së menaxhimit të integruar të kufirit të Malit të Zi (ne tekstin në vijim: Komisionet), definojnë menyrën e punës së përbashket brenda kompetencave të tyre.

## Neni 2

1. Seancat e përbashkëta të Komisioneve shtetërore mbahen me radhe, në Mal të Zi dhe në Republikën e Kosovës.
2. Në fund të takimeve, caktohet rendi i ditës, data dhe vendi i mbajtjes së seancës vijuese. Në pamundësi, rendi i ditës, data dhe vendi i mbajtjes së seancës vijuese caktohet me shkëmbimin e letrave të Kryesuesve të Komisioneve shtetërore dhe ndërmjet kanaleve diplomatike, me se voni tetë ditë para mbajtjes së seancës.
3. Në seancë, para fillimit të debatit për pikat e caktuara të rendit të ditës, Komisioni mund të propozojë amendamente për rendin e ditës.
4. Seancën e kryeson Kryesuesi i Komisionit shtetëror të shtetit ku mbahet seanca.

## Neni 3

Komisionet i mbulojnë shpenzimet për punën e tyre.

## Neni 4

1. Konkluzionet e përbashkëta dhe vendimet merren me konsensus, në përputhje me mënyrën e punës së komisioneve të themeluar nga kjo Rregullore.
2. Nëse qendrimet e komisioneve shtetërore ndryshojnë, në procesverbal regjistrohen qendrimet individuale.

## Neni 5

1. Gjuhët e punës së Komisioneve janë gjuha shqipe dhe ajo malazeze.
2. Të gjitha dokumentet, si rezultat i punës së përbashkët, përpilohen në tri origjinale, në gjuhët e punës nga paragrafi një (1) i këtij neni, dhe në gjuhën angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike.
3. Në rast paqartësie në interpretim epërsi do të ketë teksti në anglisht.
4. Dokumentet e përmendura në paragrafin një (1) të këtij Neni nënshkruhen nga Kryetarët e Komisioneve shtetërore.

## Neni 6

1. Në cdo seancë mbahet procesverbali në gjuhën shqipe dhe gjuhën malazeze.
2. Procesverbalin e nënshkruajnë Kryetarët e Komisioneve.

## Neni 7

Komisionet shtetërore janë të detyruara që t'i respektojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje, konkluzionet dhe vendimet, si rezultat i punës së përbashkët.

## Neni 8

1. Me qëllim të zgjedhjes së çështjeve specifike brenda juridiksionit të vet, Komisionet i emerojnë ekspertet/grupet.
2. Në seancën e përbashkët Komisionet nxjerrin një udhëzim pune për identifikimin - përcaktimin dhe drejtimin e shtrirjes së linjës kufitare dhe finalizimin e dokumenteve kufitare.
3. Për punën në teren në kufirin shtetëror, Komisioni duhet të njoftojë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, organet kompetente për mbikëqyrjen e kufirit shtetëror të shtetit në teritorin e të cilit janë kryer punët.

## Neni 9

1. Anëtarët e Komisionit, grupet e ekspertëve / ekspertët, dhe stafi mbështetës mundën, në kryerjen e detyrave të tyre, me dokumentet përkatëse të lëshuara nga autoritetet kompetente, të kalojnë kufirin në të gjitha pikat e tij.
2. Punimet në kufi kryhen me pëlqimin dhe pjesëmarrjen e të dy palëve.

## Neni 10

1. Anëtarët e Komisionit, grupet e ekspertëve / ekspertët dhe personeli mbështetës, gjatë ushtrimit të punëve në kufi, gëzojnë imunitet në përputhje me Konventën mbi Misionet Speciale, 1969.
2. Autoritetet përgjegjëse për çështjet e jashtme të të dyja vendeve duhet të lajmërojë palën tjetër lidhur me listën e personave që janë në sigurimin e imunitetit për qëllim të kryerjes së detyrave, konform kësaj Rregullore.
3. Automjetet, instrumentet, veglat, materialet ndertimore dhe dokumentet personale, duke përfshirë dokumentacionin kufitar në dispozicion të anëtarëve të komisioneve të përbashkëta të punës, grupet e ekspertëve / ekspertët dhe personelit mbështetës, të cilat përdoren në anën tjetër të kufirit, nuk mund të konfiskohen dhe nuk janë subjekt për tatimin mbi import -eksport dhe i depoziteve garantuese.
4. Automjetet të cilat gjatë punës së tyre i shfrytëzojnë anëtarët e Komisioneve shtetërore, grupet e ekspertëve / ekspertët dhe personeli mbështetës, duhet të posedojnë kartonin e gjelber të sigurimit.


### Neni 11

Kjo Rregullore mund të ndryshohen ose të plotësohet me marrëveshje të përbashkët të Komisioneve.


### Neni 12

1. Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetaret e Komisioneve të të dy shteteve.
2. Nënshkruar në Podgoricë, me 26.03.2013, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjuhën malazeze, ku tekstet janë njëloj autentike.

PËR KOMISIONIN E REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS



PËR KOMISIONIN E MALIT TË ZI





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E Kryeministrit - URED PREMijERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR			
Njësia Org. Org. Jedinice Org. Unit	021.a	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.:	051/4
Nr. i faqeve By stranica No. pages	-06-	Data: Datum: Date:	11/08/2015
Prishtinë / a			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror*  
*Državna Komisija za Obeležavanje i Održavanje Državne Granice*  
*State Commission for Demarcation and Maintenance of State Borders*

**Datë:** 06 gusht 2015

Nr. 4/2015

**Për:** Qeverinë e Republikës së Kosovës

**Nga:** Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror

**Subjekti:** Raport nga puna e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror - Vija kufitare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Në pajtim me nenin 40 të Ligjit për kontrollin e kufirit shtetëror, Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 12/67, të datës 21.03.2012, ka themeluar Komisionin Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, ndërsa me Vendimin nr. 05/28 të datës 08.05.2015 i ka vazhduar Komisionit mandatin 3 (tre) vjeçar.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e 140-të me Vendimin nr. 03/140 me datë 17.07.2013, ka miratuar Rregulloren QRK - nr. 17/2013 për Punën e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror (me tutje Komisioni).

Procesi i Shënimit të kufirit të Republikës së Kosovës është përshkruar në dokumentin e quajtur: Pakoja e Ahtisari 2007, Aneksi VIII, Sektori i Sigurisë në Kosovë, Neni 3 alineja 2. Kufiri i KSAK 31 Dhjetor 1988. Kjo vijë kufitare sipas Pakos të Ahtisarit është aprovuar edhe me deklaratën e shpalljes se pavarësisë të Republikës së Kosovës, me 17. Shkurt 2008. Gjithashtu kjo vijë është në përputhje të plotë me të dhënat nga viti 1974, (Kushtetuta e RSF Jugosllavisë 1974), e deri me tani.

Në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2012 janë vu kontaktet protokolare me Komisionin për demarkacion dhe përcaktimin e kufirit shtetëror, caktimin e kalimeve kufitare, përcaktimin e regjimit të trafikut ndërkufitar me shtetet fqinje dhe zbatimi i strategjisë së menaxhimit të integruar të kufirit të Malit të Zi. Në fund të vitit 2012 është mbajtur takimi i parë për koordinimin e hapave rreth punës së dy komisioneve shtetërore, dhe me pas në muajin janar dhe shkurt 2013 janë shkëmbyer draft dokumentet që më pas janë miratuar në takimin e dytë të mbajtur më 25 dhe 26 mars 2013, ku janë shqyrtuar dhe miratuar dokumentet në vijim: *Rregulloren për punën e përbashkët të Komisionit shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës dhe Komisionit për demarkacion dhe përcaktimin e kufirit shtetëror, caktimin e kalimeve kufitare, përcaktimin e regjimit të trafikut ndërkufitar me shtetet fqinje dhe zbatimi i strategjisë së menaxhimit të integruar të kufirit të Malit të Zi dhe Udhëzuesin mbi punën e përbashkët të*



*komisionit për identifikimin - përcaktimin e drejtimin e shtrirjes së linjës kufitare dhe finalizimin e dokumenteve kufitare.*

Vija kufitare ndërmjet Republikës të Kosovës dhe Malit të Zi, fillon nga tre kufiri Kosovë-Shqipëri-Mal i Zi deri në pikën tre kufi Kosovë-Mal i Zi-Serbi me gjatësinë prej 78 km. Shtrirja e vijës kufitare në mes të këtyre dy shteteve është vetëm në territor malor, duke i përshkuar pikat e larta në majat e maleve deri në 2366m lartësi mbidetare. Ndërsa pika me e ulët në vijën kufitare ndërmjet të Kosovës dhe Malit të Zi është rreth 1200m lartësi mbidetare. Komunitat Junik, Deçan, Pejë dhe Istog i kanë zonat disa zona kadastrale që njëkohësisht e përcaktojnë vijën kufitare ndërmjet me komunitat fqinje në Mal të Zi.

Komisioni ka hulumtuar, mbledhur, shqyrtuar dhe analizuar gjithë gjeoinformacionin, hartat dhe dokumentacionin për vijën kufitare ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Pastaj janë ngritur debate me ekspert, me zyrtar të lartë të Qeverisë së Kosovës, me kryetar komunash dhe me qytetarë të brezit kufitar. Për më shumë së tri vite komisioni ka gjurmuar dokumentacion por edhe ka kërkuar nga institucionet dhe nga secili qytetar që ka ndonjë dokumentacion lidhur me vijën kufitare t'ia ofrojë.

Baza e të dhënave zyrtare për Kosovën nga viti 1974 dhe të dhënat tjera në kontinuitet deri me sot 6 gusht 2015 janë identike dhe në zbatim nga organet zyrtare të Republikës së Kosovës.

Fillimisht institucioni kryesor për të dhëna kadastrale dhe kufij të Kosovës ishte "Geodetska Uprava SAPK-Prishtina" e me vonë kjo drejtori u shkrua në gjuhën shqipe "Drejtoria Gjeodezike e KSAK-Prishtinë". Drejtoria Gjeodezike e KSAK-Prishtinë ishte institucion me përgjegjësi të plotë sipas "ligjit për matje dhe kadastrë të tokave", tani ngjashëm me Agjencinë Kadastrale të Kosovës në Republikën e Kosovës.

Gjeoinformacioni dhe hartat për vijën kufitare ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi janë nga baza e të dhënave të institucioneve të Kosovës: në Zyrën kadastrale - Pejë, në zyrën për pronë-Pejë, në zyrën e Agjencisë të pyjeve dega në Pejë dhe në Zyrat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Për këtë bazë të dhënave janë të informuar të gjithë qytetarët e interesuar për vijën kufitare, të cilat personalisht i kanë vizituar dhe i kanë vërtetuar në zyrat e cekura lartë, të Komunës së Pejës (në këtë rast edhe komuna e Pejës me 70 zona kadastrale është gjithnjë me sipërfaqe të njëjtë 602.2km<sup>2</sup>). Në atë territor janë bërë trashëgimi të pronave pikërisht deri në vijën kufitare me Malin e Zi.

Komisioni i Malit të Zi ka sjellë gjeoinformacion, harta dhe të dhëna kadastrale për territorin e Malit të Zi, për vijën kufitare në përputhshmëri të plotë me vijën kufitare të Republikës së Kosovës. Përputhshmëria e të dhënave nga të dy shtetet për të njëjtën vijë kufitare vazhdonë për gjithë territorin e Republikës së Kosovës me Malin e Zi. Këto dy baza të dhënave nga të dy shtetet janë në përputhshmëri për të njëjtën vijë kufitare ndërmjet dy shteteve.

Kur ceket vija kufitare ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi në periudhën 1974-2015, natyrisht, kemi parasysh që të dhënat janë dinamike, nuk krijohen brenda një viti por kufiri dhe territori administrativ(atëherë) i KSA të Kosovës dhe sot kufiri i territorit të shtetit të Republikës së Kosovës është i njëjtë dhe i pa ndryshuar.

Përputhshmëria e vijës kufitare të Republikës së Kosovës me Malin e Zi, është e bazuar në gjeoinformacionin zyrtar të Drejtorisë Gjeodeze Krahinore në Prishtinë sipas ligjit "Ligja mbi matjen e Kadastrës e Tokëve" i nënshkruar me datë 13 Prill 1973 nga Kryetari i Kuvendit të KSAK Ilijaz Kurteshi, Fletorja Zyrtare e KSAK. Pastaj me 28 mars 1980 aprovohet "Ligji

i Matjes dhe Kadastrit i Tokave” i shpallur në Gazeta zyrtare e KSAK e vitit 1980. Në të dy ligjet është shkruar qartë se: KSA e Kosovës përgatit programet afatmesme ndërsa ato vjetore dhe mbikëqyrjen e realizon Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë në Prishtinë. Gjeoinformacioni dhe hartat e krijuar në vitin 1973, 1974 1980 dhe sot në vitin 2015 janë me kufij të njëjtë pa asnjë ndryshim që paraqitet sot.

Organizimi i atëhershëm dhe kompetencat lidhur me përkufizimin dhe mbajtjen e shënimeve të territorit që e administron me të dhënat kufitare kadastrale dhe me kadastrat e tokave në KSA të Kosovës është i ngjashëm me kompetencat e tanishme të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe të Zyrës Kadastrale të Komunave, natyrisht edhe të Pejës (krahaso ligjin për kadastër atëherë dhe sot). Këtu duhet cekur se Komuna e Pejës pas luftës ka përparësi të mëdha ndaj shumë komunave të Republikës së Kosovës, asaj nuk i mungon asnjë dokument kadastral dhe i kufijve, e ka arkivin e plotë - të pa plaçkitur nga Serbia dhe të skanuar e të Arkivuar në Zyren Kadastrale të Pejës dhe në Agjencion Kadastral të Kosovës. Kjo vërtetohet edhe me kërkesat e qytetareve të sqaruara në vijim në kapitullin 5 të këtij raporti. Prandaj, baza e të dhënave dhe gjeoinformacioni për vijën e kufirit është e pandryshuar dhe e prezantuar në vijim me gjeoinformacionin e saktë, nga komisioni në periudhën 1974-2015. Shih dokumentacionin në vijim:

- Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, para dhe pas vitit 1974;
- Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë e KSA të Kosovës para dhe pas vitit 1974;
- Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë kishte kompetenca të ngjashme me ato tani të Agjencisë Kadastrale të Kosovës;
- Geodetska Uprava SAPK-Pristina, 1974;
- Geodetska Uprava NR. Serbia 1959;
- Ligji “Ligja mbi matjen e Kadastrën e Tokëve” i nënshkruar me datë 13 Prill 1973 nga Kryetari i Kuvendit të KSAK Ilijaz Kurteshi, Fletorja Zyrtare e KSAK;
- “Ligji i Matjes dhe Kadastrit i Tokave” i shpallur në Gazeta zyrtare e KSAK me 28 mars 1980;
- Kufiri i Zonave kadastrale 1974, 1988, 2015;
- Regjistrat e ndërrimeve kadastrale në komunat kufitare 1974, 2015;
- Harta e KFOR për zonën e Sigurisë të Kosovës nga Marrëveshja e Kumanovës;
- Pakoja e Ahtisarit (kufijtë administrativ të datës 31 dhjetor 1988) e deri me tani;
- Ky gjeoinformacion, harta dhe dokumentacion gjithnjë paraqet vijën e njëjtë administrative të konvertuar në kufi shtetëror të Republikës së Kosovës;
- Kjo vijë administrative/tani kufi shtetëror ka qenë dhe është zyrtar, është përditësuar dhe përditësohet që nga viti 1974 deri me sot;
- Agjencinë Kadastrale të Kosovës 2000-2015, Autoriteti më i lartë për Gjeodezi, Kadaster dhe Hartografi është bërë në shërbim të qytetarëve në Republikën e Kosovës,
- Zyrat kadastrale të komunave Junik, Deçan, Pejë dhe Istog janë në shërbim të qytetarëve, në përditësim të dhënave kadastrale e kufitare çdo ditë pune;

- Gjeoinformacioni dhe hartat e krijuara në vitin 1973, 1974 1980, 1988 dhe sot në vitin 2015 janë me vijën kufitare të njëjtë me Malin e Zi pa asnjë ndryshim;

Nga të dhënat e përshkruara me lartë kanë përfituar shumë qytetarë të zonës që kishin prona në territor të Malit të Zi. Ata sollën dokumentacionin pastaj sipas udhëzimeve të komisionit e regjistruan pronën tyre ku e kishin edhe më herët, ndaj rastet janë mbyllur nga vetë Komunitat kufitare: Juniku, Deçani dhe Istogu (Burimi).

Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror të Republikës së Kosovës (komisioni - KShShMKSh) realizoi takime në zyre, në salla të mëdha dhe në terren me kryetaret e komunave të brezit kufitar, me banorët e fshatrave të brezit kufitar. Takimi me Kryetarin e Komunës së Pejës, ish Kryetari z. Ali Berisha. Takimi me datë, 05 03 2014 në zyrën e kryetarit z. Gazmend Muhaxheri qe pjesëmarrës ishte edhe përfaqësuesi i zyrës kadastrale të Pejës z. Shkëmb Kastrati-gjeodet dhe dhjetëra qytetar nga brezi kufitar. Në këtë takim komisioni - KShShMKSh prezantoi gjeoinformacionet e vijës së kufirit me Malin e Zi. Gjithashtu u sqarua jo njëherë “se vija kufitare me Malin e Zi do të shënohet sipas të dhënave kadastrale të komunave e në këtë rast edhe Komuna e Pejës i ka në shfrytëzim nga viti 1974 e cila është e njohur për Ju, e dini të gjithë”. Këtë e sqaroi edhe përfaqësuesi i zyrës kadastrale të Pejës z. Shkëmb Kastrati gjeodet i cili e ceku: “Zyra kadastrale e Komunës së Pejës edhe sot e kësaj dite azhurnimin dhe piketimin e të dhënave kadastrale e bënë në të njëjtat plane kadastrale me të njëjtën vij kufitare si në vitin 1974 ashtu edhe sot në 2014”. Pas kësaj nga komisioni - KShShMK u kërkua nga qytetarët e interesuar që ta konsultojnë Kadastrin e Pejës lidhur me pronat e tyre sepse aty i keni të gjitha shënimet zyrtare, e në rast vështirësie Komisioni iu ndihmon. Njëkohësisht të gjithë të pranishmeve iu sqarua dallimi në mes të pronësisë dhe shfrytëzuesit mbi pronën e paluajtshme. Gjithashtu informacioni për kufirin shtetëror u paraqit edhe me projektor.

Pronaret nga Kosova të cilët kishin prona në komunën: Plavë (Bjelluhë), Beranë (Vllahovi) dhe Rozhajë (Gradinë), pas këtyre takimeve me përfaqësuesit e komunave dhe me qytetarët e zonave kufitare sollën listën me 37 emra të cilët i kanë përkufizuar dhe realizuar pronat e tyre në Mal të Zi. Kjo listë është e arkivuar me adresa të sakta të pronareve dhe shitesë e këtij raporti.

Banorët e fshatrave të komunës së Pejës, Deçanit dhe Istogut me datë 06 06 2013, bëjnë kërkesë në Kuvendin e Republikës së Kosovës: “Kërkesa jonë është të na mundësohet lejimi i daljes në bjeshkë vetëm për shfrytëzimin e kullosave”, pastaj fjalja tjetër në kërkesë është “Edhe pse për këto bjeshkë ka dëshmi të shumta qe banorët e këtyre fshatrave i kanë blerë dhe kanë paguar taksë për shfrytëzimin e kullosave në komunën e Rozhajës”. Kërkesës se lartcekur i ishte bashkëngjitur edhe kërkesa e tyre e më hershme e dërguar me nënshkrime të Kryetari i Komunës së Rozhajës z. Nusret Kalaq. Këto dy shkresa janë të arkivuara dhe e bashkëngjitur në këtë raport.

Komisioni, gjatë procesit të shënjimit të vijës kufitare ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, ka pas në konsideratë kujdesin maksimal ndaj pronave në zonën kufitare, duke kërkuar nga secili pretendues- pronar të bëjë kufizimin e pronës se vete në terren sipas dokumentacionit që ka. Gjithashtu Komisioni ka mbajtur dhjetëra takime me banoret e zonës kufitare, për të iu sqaruar të dhënat dhe për të shqyrtuar kërkesat e tyre. Në këtë aktivitet, pronat e qytetarëve nga komuna e Junikut, Deçanit, Pejës dhe Istogut në territorin e Malit të Zi për të cilët kishte dokumentacion janë përkufizuar atje. Tani, ato prona të përkufizuara, duke iu falënderuar bashkëpunimit të qytetareve me komisionin, i kanë në pronësi dhe janë duke i shfrytëzuar pa asnjë pengesë.

Parimet e Komisionit Shtetëror përveç argumenteve profesionale relevante dhe saktësisë, janë Transparenca dhe Informimi për progresin e punës në shënjimin e vijës kufitare duke prezantuar dokumentacionin relevant për kufirin. Përveç raportimit të rregullt në Kryeministri, në Ministri të Punëve të Jashtme dhe Ministri të Punëve të Brendshme, janë mbajtur edhe një varg takimesh me kryetaret dhe këshilltaret e komunave të brezit kufitar, si të komunës së Junikut, Deçanit, Pejës dhe Istogut dhe takimet me banoret në terren pranë zonave kufitare. Gjithashtu janë realizuar edhe takimet trelaterale ndërmjet Republikës së Kosovës, Malit të Zi dhe Republikës së Shqipërisë.

Komisioni për prezantim dhe sqarime të vijës kufitare ka organizuar: 16 takime bilaterale, 2 takime trelaterale, 17 takime të rregullta të komisionit vendor sipas rregullores së punës. Janë organizuar dhe mbajtur mbi 20 takime të drejtpërdrejta në terren me qytetaret e zonë, takime me kryetaret e Komunave kufitare si me: Haki Rugova-Istog, ish kryetarin e Pejës Ali Berisha, me kryetarin aktual Gazmend Muhaxheri-Pejë, Rasim Selmanaj-Deçan, Agron Kuçi-Junik. Takimet janë mbajtur në zyrat e tyre Komunale. Po ashtu, komisioni ka bërë prezantim informues në Asamblenë e Komunës së Pejës me 13 Mars 2015 para asamblistëve dhe qytetareve të komunës së Pejës, duke ofruar dokumentacionin relevant për kufirin Kosovë-Mali i Zi. Për të gjitha takimet e sipër cekura janë përgatitur materialet, janë dhënë sqarime dhe janë procesverbalet e arkivuara në Sekretarinë e Komisionit. Është bërë trajtimi i përbashkët dhe analiza e dokumentacionit të sjellë nga Agjencia e Pyjeve për territorin e brezit kufitar me Malin e Zi.

Komisioni ka bërë trajtimin e secilës pikë veç e veç në vijën kufitare, ka përshkuar në terren vijën kufitare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi duke zbatuar parimin e transparencës.

Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror dëshiron të sigurojë, Qeverinë e Republikës së Kosovës me qytetarët e saj, se është duke kryer me përkushtim, devotshmëri, me profesionalizëm të lartë dhe me përpikëri detyrat ligjore dhe teknike. Shënjimi i vijës kufitare me Malin e Zi është në përputhshmëri të plotë me linjën kufitare sipas Kushtetutës së vitit 1974, me Planin e Ahtisaarit dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Baza e të dhënave për zonat kadastrale në vijën kufitare e garanton mos ndryshmin e kufirit të Republikës së Kosovës me Malin e Zi, prandaj kushdo që interesohet për pronat e tyre apo për territorin e Republikës së Kosovës, mund të shkoj në Zyrën Kadastrale të komunës përkatëse dhe të Kryetari i Komunës, që ta vërtetoj cilin territor të komunës ai e administron dhe me cilat të dhëna për cilin territor të komunës u ka shërbyer qytetareve që nga vitit 1974 e deri me sot korrik 2015. Ndërsa për pronat që i kanë në Mal të Zi, natyrisht duhet të paraqiten atje. Politikisht duhet deklaruar vet Kryetaret e Komunave nëpërmjet zyrës kadastrale komunale deri ku e kanë territorin komunal. Të njëjtat gjeoinformacione, harta dhe dokumente me të njëjtën vijë kufitare me Malin e Zi ato komuna e kanë në dispozicion në gjithë periudhën, 1974, 1988 dhe sot 2015.

Përputhshmëria e vijës kufitare të Republikës së Kosovës me Malin e Zi, si u cek me lartë është e bazuar në gjeoinformacionin zyrtar të Drejtorisë Gjeodete Krahinore në Prishtinë sipas ligjit “Ligja mbi matjen e Kadastrën e Tokëve” i nënshkruar me datë 13 Prill 1973 nga Kryetari i Kuvendit të KSAK Ilijaz Kurteshi, Fletorja Zyrtare e KSAK. Pastaj me 28 mars 1980 aprovohet “Ligji i Matjes dhe Kadastrit i Tokave” i shpallur në Gazeta zyrtare e KSAK. Në të dyja ligjet është shkruar qartë se : KSA e Kosovës përgatit programet afatmesme ndërsa ato vjetore dhe mbikqyrjen e realizon Drejtoria Krahinore e Gjeodezisë në Prishtinë.

Gjeoinformacioni dhe hartat e krijuara në vitin 1973, 1974 1980 dhe sot në vitin 2015 janë me kufij të njëjtë me Malin e Zi pa asnjë ndryshim, kjo është konstatuar edhe për periudhën e viteve 1933/34, 1959 të përpiluara nga “Geodetska Uprava NR Serbije”.

Për ta lehtësuar edhe me shumë kuptimin e kësaj që u tha deri me tani në vazhdim janë gjeoinformacionet dhe hartat në mënyrë kronologjike duke filluar nga krijimi i sektorëve trigonometrik për gjithë RSF të Jugosllavisë në kuadër të cilës ishte edhe Kosova e deri në gjeoinformacionin dhe hartën kadastrale të azhurnuar nga kadastri i komunave kufitare (Junik, Deçan, Pejë dhe Istog), të arkivuara atje dhe në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Nuk ka forcë, as mjet që e detyrojnë Komisionin Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror të punoj kundër interesave të shtetit të vet-të Republikës së Kosovës.

Komisioni e ka bërë punën hulumtuese, profesionale dhe shkencore duke vërtetuar dhe ofruar për vijën kufitare çdo gjeoinformacion të nevojshëm, prandaj është garantuar që asnjë milimetër katror i territorit të Republikës së Kosovës, me këtë vijë kufitare nuk do të tjetërsohet.

Këtij raporti i bashkëngjitet i tërë dokumentacioni i trajtuar nga Komisioni për shënimin e vijës kufitare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, duke përfshirë gjeoinformacionin, hartat, dokumentacionin e nevojshëm dhe marrëveshjen dypalëshe me shtojcat për kufirin shtetëror.

Me respekt nga: Komisioni shtetëror:

Prof. Dr. Murat Meha,

Kryesues komisioni,

Mr.sc. Sylë Ukshini,

Anëtar komisioni,

Kolonel Shaban Guda

Anëtar komisioni,

Mr.sc Besim Kajtazi

Anëtar komisioni,

Prof. Dr. Tefik Basha,

Anëtar komisioni,





Mali i Zi  
Qeveria e Malit të Zi

Ministria e Punëve të Brendshme  
Komisioni për kryerjen e punëve të demarkacionit dhe për definimin, caktimin e vendkalimeve kufitare, përcaktimin regjimit të qarkullimit kufitar me vendet fqinje dhe për zbatimin e Strategjisë së menaxhimit të integruar të kufirit



Republika e Kosovës  
Qeveria e Republikës së Kosovës  
Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror

Në mbështetje të nenit 6 të Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës, komisionet në takimin e tyre të përbashkët më: 06.12. të vitit 2013, nxjerrin këtë:

**UDHËZIM TË PËRBASHKËT  
PËR SHËNJIMIN EKUFIRIT SHTETËROR, TË SHENJAVE TË  
KUFIRIT DHE TË BREZIT KUFITAR PËRGJATË KUFIRIT NDËRMJET MALIT  
TË ZI DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1.**

Me këtë Udhëzim rregullohet mënyra e punës së përbashkët së komisioneve në shënjimin e kufirit shtetëror, mirëmbajtja e vijës kufitare, e shenjave të kufirit dhe e brezit kufitar përgjatë kufirit.

**TRUPI I PËRBASHKËT I PUNËS**

**Neni 2.**

Trupi i përbashkët i punës i palëve të marrëveshjes do të bëjë shënjimin në terren të kufirit shtetëror të përcaktuar me marrëveshje dhe do të hartojë dokumentacionin e kufirit shtetëror të përbashkët

Përbërja e trupit të përbashkët të punës:

Grupi i punës i Malit të Zi:

- Velizar Femić, Drejtorja e paluajtshmërive;
- Vojo Vojinović, Drejtorja e paluajtshmërive -NJR Beran;
- Muamera Dizdarević, Drejtorja e paluajtshmërive - NJR Rozhajë;
- Bogoslav Dašić, Drejtorja e paluajtshmërive -NJR Plavë.

Grupi i punës i Republikës së Kosovës:

- 1.Reshat Murati, Agjencioni Kadastral i Kosovës
- 2.Zekrija Elezi, sektori privat
3. Esat Xani, Agjencioni Kadastral i Kosovës
4. Zyrtari nga Zyra kadastrale, Junik/Deçan/Pejë/Istog

Sipas nevojës do të angazhohen edhe ekspert të tjerë në të dy grupet.

## PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT TË KUFIRIT

### Neni 3.

Trupi i përbashkët i punës do të përgatisë elaboratin e dokumentacionit kufitar i cili përmban:

- Harta topografike në përpjesë 1:25 000 me vijën e skicuar kufitare dhe koordinatat e pikave thyese kufitare;
- Lista e koordinatave të pikave thyese kufitare;
- Përshkrimi tekstual i shtrirjes së kufirit shtetëror i cili përmban listën e koordinatave dhe incizimet acrofotogrametrike;
- Paraqitja e linjës kufitare në listat e planeve kadastrale më përshkrimin e saj;
- Paraqitja e koordinatave të të gjitha shenjave kufitare.

## PAMJA E SHENJAVE KUFITARE

### Neni 4.




Fig. 3: Shenja e trekufirit




Fig. 4: Shenja kryesore kufitare



Fig. 5: Shenja kufitare ndihmëse



Fig. 6: Shenja kufirit natyror (guri)

## PAMJA E SHENJAVE ZYRTARE NË SHENJAT KUFITARE

### Neni 5.

KK

MNE

Figura 1: Pamja e shenjave zyrtare të R. Kosovës në shenjën kufitare

Figura 2: Pamja e shenjave zyrtare c Malit të Zi në shenjën kufitare

Skica e formave të të gjitha llojeve të shenjave kufitare ( dimensionet, lloji i materialit , vija e cila shënon drejtimin e shtrirjes së vijë kufitare etj.), përshkrimi i tyre dhe mënyra e mirëmbajtjes janë pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi.

## CAKTIMI KOORDINATAVE TË SHENJAVA KUFITARE

### Neni 6.

Caktimi i koordinatave të shenjave kufitare në vijë kufitare është e domosdoshme të bëhet në bazë të rrjeteve gjeodezike të të dyja shteteve dhe sipas projektit të hartuar.

### Rilevimi aerofotogrametrik

### Neni 7.

Pas vendosjes së pikave kufitare në linjën kufitare dhe pas matjeve gjeodezike, në bazë të projektit të përbashkët, do të bëhet i rilevimi aerofotogrametrik në gjerësi prej prej 3 km nga të dyja anët e kufirit.

Shpenzimet, të dy palët do t'i ndajnë në mënyrë të barabartë.



## Sistemi gjeografik i informacionit për kufirin

### Neni 8.

Për të mirëmbajtur kufirin në aspektin teknik, juridik dhe të sigurisë, organet e administratës me kompetencë për çështje të paluajtshmërive, përkatësisht të kadastrit, do të përgatisin sistemin gjeografik të informacionit për kufirin, me qëllim të krijimit të bazës së të dhënave për menaxhimin e të dhënave për vijën kufitare dhe për krijimin e bazës së të dhënave.

### Dukshmëria e linjës kufitare

### Neni 9.

Punët e monitorimit të mirëmbajtjes së vijës kufitare, konform Marrëveshjes për kufirin shtetëror, pastrimin nga drunjtë dhe shkurret tjera, të cilat zvogëlojnë dukshmërinë e shenjave kufitare ose të vijës kufitare, në gjerësi prej tre metrash nga të dyja anët e kufirit, e bëjnë organet kompetente të palëve kontraktuese.


Trupi i përbashkët punues është përgjegjës edhe për mirëmbajtjen dhe rekonstruimin e shenjave kufitare në kufirin shtetëror.

## NDRYSHIMET NË PËRBËRJEN E PERSONELIT TË TRUPAVE TË PËRBASHËTA TË PUNËS

### Neni 10

Ndryshimet në përbërjen e personelit të trupave të përbashkëta të punës, do t'i këmbëjnë kryetarët e komisioneve, në rrugë diplomatike.

KOMISIONI I REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS



Prof. dr. Murat Meha

KOMISIONI I MALIT TË ZI



Milan Paunović



**Republika e Kosovës**  
*Qeveria e Republikës së Kosovës*

*Komisioni shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror*



**Mali i Zi**  
*Qeveria e Malit të Zi*  
*Ministria e punëve të brendshme*

*Komisioni për demarkacion dhe përcaktimin e kufirit shtetëror, caktimin e kalimeve kufitare, përcaktimin e regjimit të trafikut nderkufitar me shtetet fqinje dhe zbatimi i strategjisë së menaxhimit të integruar të kufirit*

Ne baze të Nenit 8, paragrafit 2, të Rregullores për punën e përbashkët të Komisioneve, Komisionet në seancën e përbashkët të datës 25.03.2013. kanë sjellë këtë

**UDHËZUES**  
**PËR PUNËN E PËRBASHKËT TË KOMISIONEVE**  
**PËR IDENTIFIKIMIN, PËRCAKTIMIN DHE DREJTIMIN E SHTRIRJES SË LINJËS KUFITARE DHE**  
**FINALIZIMIN E DOKUMENTEVE KUFITARE**

**Neni 1**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

1. Ky Udhëzues rregullon mënyrën e punës së përbashkët të Komisioneve për të identifikuar dhe përcaktuar drejtimin e shtrirjes së linjës kufitare dhe finalizimin e dokumenteve kufitare.
2. Në përbërje të Komisionit mund të angazhohen ekspertë ose grupe ekspertësh për të identifikuar linjat kufitare dhe finalizuar dokumentet kufitare (në vijim të referuara: grupet e ekspertëve / ekspertët).
3. Komunikimi ndërmjet Komisioneve të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, kryhet ekskluzivisht përmes Kryetarëve të Komisioneve.

## Neni 2 BAZAT

1. Për përgatitjen e dokumenteve kufitare për identifikimin e saktë të linjës kufitare, do të përdoren parametrat e mëposhtme:
  - 1.1. Hartë topografike 1:25000 (në tekstin në vijim HT25), të cilat do ti bashkangjiten Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim Marrëveshjes);
  - 1.2. Listat e hartave bazë shtetërore, proporcionet 1:10 000 dhe 1: 5 000 (HBSH 1:10 000 dhe 1:05 000);
  - 1.3. Planet kadastrale dhe studimet mbi kufijtë kadastral në mes të ish-Jugosllavisë, Malit të Zi dhe Serbisë – KA Kosovë;
  - 1.4. Dokumente te tjera.

## Neni 3 IDENTIFIKIMI I LINJËS KUFITARE

1. Identifikimi i linjës kufitare kryhet në bazë të treguesit të shtrirjes së linjës kufitare në listat e HT25, nga Neni 2, Paragrafi 2 të këtij Udhezuesi.
2. Identifikimin e saktë të linjës kufitare do të bëhet në planet topografike - kadastrale me saktësi të madhe dhe detaje që janë në dispozicion për zonën e caktuar.
3. Në rastet kur komisioni nuk mund të pajtohen në bazë të dokumentacionit të përcaktuar në paragrafi 2 i këtij Neni, është e mundur që ta identifikojë linjën kufitare me anë të inspektimit në terren dhe në bazë të një marrëveshjeje përcaktohen koordinatat e pikave thyese të linjës kufitare në projeksionin e Gauss-Kruger.
4. Në përgatitjen e dokumenteve saktë të identifikuar të linjës kufitare, komisionet do të zbatojnë parimet e mëposhtme, në mënyrë që linja kufitare kur është e mundur të:
  - 4.1. ndjek rrjedhën natyrore të relievit dhe ujëravat;
  - 4.2. kaloj jashtë lagjeve dhe te mos i ndaj objektet;
  - 4.3. kaloj, si rregull, nepër një nga skajet e jashtme të rrugëve;
  - 4.4. te mos i prej objektet e infrastrukturës ose ato të ngjajshme të cilat gjinden në zonën kufitare;
  - 4.5. monumentet e rëndësishme natyrore dhe kulturore në zonën e ngushtë të mbrojtur mbesin në shtetin për të cilin kanë rëndësin e duhur, në përputhje me Paragrafin 5, të këtij Neni.
5. Duke zbatuar parimet e Paragrafit 4, të këtij Neni dhe kriteret "*metër për metër*," Komisionet mund të propozojnë korigjimin e linjës kufitare të propozuar me Marrëveshjen HT25 , në një maksimum prej 150m në procedurën e identifikimit.
6. Për çdo korigjim të tillë nga Paragrafi 5 i këtij Neni, duhet të përpilohet procesverbali dhe të dhënat grafike të argumentuara dhe ti dorëzohen Komisioneve në verifikim.
7. Për rezultatet e identifikimit te pjesës së linjës kufitare në terren mbahet procesverbali të cilin e nënshkruajnë Kryetarët e Komisioneve. Procesverbalit i bashkangjiten kopjet zyrtare të hartave HT25, kopjet e listave HBSH 1:10 000 dhe 1: 5 000, kopjet e planeve kadastrale dhe dokumenteve të tjera përkatëse.

**Neni 4**  
**PËRPUNIMI (FINALIZIMI) I DOKUMENTEVE KUFITARE**

1. Komisioni do ti përpunojë dhe finalizojë dokumentet kufitare, si në vijim:
  - 1.1. Shfaqja e linjës kufitare shtetërore e cila gjindet në HT2;
  - 1.2. Përshkrimi i linjës kufitare e cila gjindet në HT25;
  - 1.3. Shfaqja e linjës kufitare të kufirit shtetëror në listat e hartave kadastrale;
  - 1.4. Përshkrimi i linjës kufitare të kufirit shtetëror në listat e hartave kadastrale;
  - 1.5. Lista e koordinatave e pikave thyese të linjës kufitare;
  - 1.6. Dokumentet profesionale, teknike me katalog të shenjave kufitare dhe dokumenteve tjera të nevojshme për shënjimin e linjës kufitare në terren (skica, harta, lista e koordinatave dhe ortophoto);
  - 1.7. Marrëveshja për kufirin shtetëror në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi.

**Neni 5**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

1. Grupet e ekspertëve / ekspertët rregullisht do të raportojnë Komisionet shtetërore lidhur me veprimet e ndërmarra dhe punën e kryer.
2. Ky Udhëzues hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Nënshkruar në Podgoricë, më 26.03.2013, në dy origjinale, në gjuhën shqipe dhe atë malazeze.

**PËR KOMISIONIN E REPUBLIKËS SË KOSOVES**



---

**PËR KOMISIONIN E MALIT TË ZI**



---